



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Adresa: Rr. Reshit Çollaku, Tel: 0800 9999, Website: www.hidaa.gov.al, E-mail: info@hidaa.gov.al

SHTOJCA 2

Nr.
Indeksi
në
13462
2017

DEKLARATË E PASURISË

Plotësohet nga subjekti i rivlerësimit që mbart detyrimin për deklarim të pasurisë së tij, të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe të fëmijëve madhorë dhe çdo personi të përmendur në certifikatën familjare, në bazë të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";

A U T O R I Z M
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË PASURISË

Emri
SEMIRAMIS

Atësia
XHEVDET

Mbiemri
HOXHOLLI

Funksioni
GJYQTARE

Institucioni dhe adresa

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË, Bulevardi "Gjergj Fishta", Tiranë.

Data e emërimit në detyrë

20.11.2015

Data e dorëzimit të deklaratës

20.01.2017

Në bazë të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";

A u t o r i z o j :

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Institucionet e rivlerësimit, vëzhguesit ndërkombëtarë të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë vendit, pasuritë, interesat privatë dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time dhe personave të lidhur me mua.

Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.

**KUJDES ! KY ËSHTË DOKUMENT ZYRTAR DHE PASQYRIMI I TË DHËNAVE TË PAVËRTETA, TË PAPLOTA, E TË PASAKTA E BËN DEKLARATËN
TË RREME DHE NDËSHKOHET PENALISHT.**

Nënshkrimi i subjektit



Informacion në ndihmën tuaj

Detyrimi për deklarimin dhe kontrollin i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta, sanksionohet në ligjin “Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

ILDPKI, bazuar në deklarimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Mbi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Deklarimi i pasurisë nga subjekti i rivlerësimit

- Dokumenti zyrtar “Deklaratë e pasurisë” duhet të plotësohet nga subjekti i rivlerësimit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit “Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit të rivlerësimit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es dhe fëmijëve në moshë madhore dhe çdo person të përmendur në certifikatën familjare), bashkëjetuesit/es, burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit, përfshirë interesat privatë që i ka në pronësi ose në përdorim, sipas nenit 3, pikat 9 dhe 11, të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes, bashkëjetuesit/es është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes, bashkëjetuesit/es me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim.
- Deklarata e Pasurisë plotësohet në mënyrë elektronike, por në çdo rast nënshkruhet me shkrim.
- Subjekti i rivlerësimit nuk legjitimohet të nënshkruajë deklaratën e pasurisë të personave të lidhur.

Deklarimi i pasurisë nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit

- Personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, (**bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore** dhe çdo person të përmendur në certifikatën familjare), i cili mbart detyrimin për deklarim të pasurisë në Inspektoratin e Lartë, plotëson formularin përkatës nga faqja 9-13 e këtij dokumenti.
- Në çdo rast, personi i lidhur, është i detyruar të plotësojë faqen e parë të deklaratës, **AUTORIZIMI** ku deklaron nëse ka ose jo pasuri të regjistruara në emrin e tij. Formulari i plotë do të plotësohet vetëm në rastet kur personi i lidhur ka pasuri të regjistruar veçmas.

Deklarimi i pasurisë nga persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit

- Persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 3, pika 14, të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesit me subjektin e rivlerësimit, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi. Personat e tjerë të lidhur nëse konfirmojnë këto marrëdhënie më subjektin e rivlerësimit, mbartin detyrimin për deklarimin e pasurisë në Inspektoratin e Lartë me kërkesë të Inspektorit të Përgjithshëm të Deklarimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kujdes!

Të gjithë subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore dhe çdo person të përmendur në certifikatën familjare), të cilët bëhen subjekte të këtij ligji dhe plotësojnë deklaratën e pasurisë, nuk mund të mbajnë dhe të deklarojnë gjendje në Cash jashtë sistemit bankar mbi shumën 1,5 (një presje pesë) milion lekë. Depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve Cash mbi vlerën 1,5 (një presje pesë) milion lekë, është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave privatë në ILDKPKI.

Sanksionet:

Mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës së pasurisë mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, sipas ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Kujdes!

Të gjitha faqet e deklaratës duhet të nënshkruhen nga subjekti i rivlerësimit, në të kundërt deklarata do të kthehet dhe do të konsiderohet e padorëzuar në Inspektoratin e Lartë.

- Për informacione të mëtejshme, kontaktoni në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, me “Sekcionin e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse” në numrat e telefonit **042 259 461** Free.08009999, info@hidaa.gov.al.

DEKLARIMI I PASURIVE

Objekti i deklarimit: Të gjitha pasuritë e akumuluara ndër vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas nenit 3, pika 11, të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur.

Përshkruani hollësisht: Ilojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumën e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %
1.	Llogari rrjedhëse [REDACTED] Raiffeisen Bank, e krijuar nga kursimet nga paga si Gjyqtare stazhiere në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (llogari page).	Gjendja aktuale në llogari sipas vërtetimit (statement-it bankar) është 370.32 lekë (treqind e shtatëdhjetë pikë tridhjetë e dy lekë).	100 %

* Neni 3, pikat 11 dhe 19, të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", nen 4 i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Mbi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare, të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë";

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, në pronësi dhe në përdorim të subjektit të rivlerësimit;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to, të cilat janë në pronësi dhe në përdorim të subjekti të rivlerësimit;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 lekë;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në **Cash**, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj brenda dhe jashtë vendit;

* Neni 4/1 i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Mbi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare, të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë"; Subjekti që plotëson këtë deklaratë, nuk mund të mbajë dhe të deklarojë gjendje në Cash jashtë sistemit bankar mbi shumën 1,5 (një presje pesë) milion lekë. Depozitimi në institucionet bankare i gjendje Cash mbi vlerën 1,5 (një presje pesë) milion lekë, është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave privatë në ILDKPKI.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit

Semiramis Hoxholi 

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

ANGAZHIME DHE VEPRIMTARI PRIVATE DHE/OSE PUBLIKE**DHE TË ARDHURAT E KRIJUARA PREJ TYRE**

Objekti i deklarimit: Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie e kryer brenda ose jashtë vendit, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, licenca dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; të subjektit, bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore. Të ardhurat nga paga neto duke filluar që nga momenti i fillimit të detyrës deri ditën e deklarimit, të ardhura nga qiratë për vete dhe personat e lidhur në përputhje me nenin 3, pika 19, të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";

Përshkruani hollësisht çdo lloj angazhimi dhe veprimtarie që ka sjellë të ardhura, emërtimi i institucionit, i organizatës apo i aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrit publik, statusi, objekti i veprimtarisë së organizatës, funksioni dhe/ose natyra e angazhimit. Të ardhurat nga paga neto duke filluar që nga momenti i fillimit të detyrës deri ditën e deklarimit, të ardhura nga qiratë për vete dhe personat e lidhur.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave <u>neto</u> të krijuara, në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë)
1. Paga si Gjyqtare stazhiere pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën nga 20.11.2015 deri më 30.12.2016.	Të ardhurat neto për këtë periudhë janë në total: 1 082 068 (një milion e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëdhjetë e tetë) lekë. Për më tepër lexoni në dokumentat referues.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit

Nëse ky format është i pamjaftueshëm,
vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij

"Deklarata e pasurisë për procesin e rivlerësimit"

Semiramis Hoxhali *Semj*

DETYSIMET FINANCIARE NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË

- Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë vendit, të mbetur ende pa u shlyer deri në datën e deklarimit të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.
- Të dhënat për emra personash, ndaj të cilëve keni detyime financiare, të pasqyrohen në faqen nr. 8, për të ruajtur konfidencialitetin e tyre.

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit finanziar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë, për kreditë bankare (principal), kohëzgjatjen (muajin/vitin) dhe kësttin mujor.

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, deri në datën e fillimit të rivlerësimit. (me shifra dhe me fjalë)
1.Kontratë qeraje me afat një-vjeçar për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2017, me qëllim marrjen prej meje të një banese me qera të ndodhur pranë [REDACTED] [REDACTED], Tiranë. Kontrata është lidhur verbalisht, pra pa formë shkresore, në përputhje me dispozitën 803/4 të Kodit Civil.Kësti i pagesës së rënë dakord është 6000 (gjashtë mijë) lekë në muaj.	Nuk më ka mbetur asnjë detyrim financiar pa shlyer.
2. Kontratë kredie me kufi (Overdraft), lidhur në datë 14.12.2016 dhe me vlefshmëri deri më 25.11.2017. Kjo kontratë ka për objekt dhënien e kredisë me kufi (overdraft) deri në shumën prej 80000 ALL në llogarinë rrjedhëse bankare me kërkesën time si kredimarrëse, shumë e cila është akorduar kundrejt kushtit që të kthehet së bashku me interesin e aplikuar mbi balancën debitore TRIBOR 1-vjeçar + 10.1% brenda datës 25.11.2017, datë në të cilën kontrata përfundon.	Shuma e detyrimit financiar që më ka mbetur e pashlyer nga kontrata e lidhur është në total 79,941.91 (shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e dyzet e një pikë nëntëdhjetë e një) lekë. (për më tepër referojuni kontratës overdraft bashkëlidhur këtij formulari si dhe vërtetimit bankar të datës 09.01.2017).

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit

Semiramis Hoxholla *Sefi*